



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
DREJTORIA LIGJORE  
SEKTORI JURIDIK

(2)

PROJEKT VENDIM

NR. \_\_\_, DATË \_\_\_ / \_\_\_ / 202\_\_\_

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE  
MENAXHIMIN E ZJARREVE NË PYJE DHE KULLOTA  
TË BASHKISË DURRËS PËR VITIN 2025.**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, të Ligjit 57/2020 "Për pyjet", ligji Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", Ligji nr. 45/2019 datë 18.7.2019 "Për Mbrojtjen Civile", Ligji 9693 datë 19.03.2007 "Për fondin kulloso", i ndryshuar, Ligji nr. 9244, datë 17.6.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore" (ndryshuar me ligjin nr.69/2013, datë 14.2.2013; nr. 131/2014, datë 2.10.2014; nr. 68/2023, datë 21.7.2023). VKM -së nr.807, datë 28.12.2023 "Për miratimin e planit kombëtar për emergjencat civile", VKM-së nr.1080, datë 22.12.2010 "Mbi rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota", VKM -së nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Bashkisë Durrës" e ndryshuar me VKM-në nr. 134 datë 03.03.2021, Urdhërit nr.417, datë 25.10.2024 "Për ngritjen e Komisionit të Mbrojtjes Civile", i ndryshuar, VKM nr. 60, datë 26.1.2022 Për shpalljen e ekosistemeve natyrore rezervat natyrore i menaxhuar/park natyrore (kategorië iv), si dhe miratimin e ndryshimit të statusit e të sipërfaqeve ekzistuese të zonave të mbrojtura mjedisore, që i përkasin kësaj kategorie, dhe sipas relacionit të përgatitur nga Sektori i Administrimit të Pyjeve në Bashkinë Durrës, kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës të shqyrtojë në përpunje me aktet ligjore dhe,

**TË VENDOSË:**

1. Miratimin e planit të masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në pyje dhe kullota të bashkisë Durrës për vitin 2025 sipas dokumentacionit bashkalidhur miratuar nga titullari i institucionit.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Administrimit të Pyjeve, Sektori i Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (MZSH) pranë bashkisë Durrës, Komisioni i Mbrojtjes Civile, Sektori i Bujqësisë dhe Njësitë Administrative.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.


**DREJTORIA LIGJORE**

Drejtor



**DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE**  
Drejtor

Ardian Rizaj




**DREJTORIA E MBROJTJES  
NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI**  
Drejtor

Shkëlqim Koplini



**KRYETAR**

Emiriana Sako





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
DREJTORIA LIGJORE  
SEKTORI I PYJEVE DHE KULLOTAVE

RELACION

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE PËR MENAXHIMIN E ZJARREVE  
NË PYJE DHE KULLOTA PËR VITIN 2025**

**A. Baza ligjore.**

- Ligjit 57/2020 "Për pyjet", neni 30, pika 3, 4, 5, 6.
- Ligjit 9693 datë 19.03.2007, i ndryshuar "Për fondin kulloso".
- Ligji nr. 45/2019 datë 18.7.2019, "Për Mbrojtjen Civile".
- Ligjit Nr. 152/2015, datë 21.12.2015, "Për shërbimin mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin".
- Ligjit nr.9244, datë 17.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore" (ndryshuar me ligjin nr.69/2013, datë 14.2.2013; nr.131/2014, datë 02.10.2014; nr. 68/2023, datë 21.7.2023).
- V.K.M.-së nr.807, datë 28.12.2023 "Për miratimin e planit kombëtar të emergjencave civile"
- V.K.M.-së nr.1080, datë 22.12.2010 "Mbi rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota".
- V.K.M.-së nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Bashkisë Durrës", e ndryshuar me V.K.M.-në nr. 134 datë 03.03.2021.
- Urdhërit nr.414, datë 25.10.2024 për K.M.C.

**B. Relatimi i çështjes.**

**Të nderuar këshilltarë !**

Bashkia Durrës, paraqet kërkesën për hartimin e këtij plan menaxhimi për parandalimin dhe masat që duhen marrë për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri për vitin 2024. Ky plan menaxhimi hartohej në zbatim të detyrimeve dhe akteve ligjore e nënligjore për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri si dhe përballimin e situatave emergjente.

Miratimi i këtij plani menaxhimi për zjarret në pyje e kullota ka për qëllim inspektimin, parandalimin, shuarjen e zjarreve, mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, si dhe zgjedhjen e riskut kur ndodhin këto zjarre. Origjina e këtyre zjarreve mund të vijë nga shkaqe natyrore, si dhe nga ato të shkaktuara nga dora e njeriut. Zjarret si fenomen përshkruhen si fatkeqësi natyrore pasi ndikojnë në jetën e përditëshme të njerëzve, gjëne e gjallë, pronën, mjedisin etj. Në kuadrin e transferimit të pyjeve dhe kullotave pranë Bashkive, struktura përgjegjëse harton këtë plan të menaxhimit të zjarreve në pyje dhe kullota për vitin 2024 duke u bazuar dhe në analizën e shkaqeve të zjarreve si dhe në faktorët që influencojnë në shkaktimin dhe përhapjen e zjarreve në territorin e bashkisë. Bashkia Durrës ka një relief fushor dhe kodrinor, pyjet në territorin e bashkisë tonë janë pyje të ulët, kryesisht cungishte e shkurre dhe shtrihen në zonën kodrinore. E gjithë zona që përfshihet brënda territorit administrativ të bashkisë është një rezik përfshikues i zjarreve në pyje dhe kullota. Gjatë vitit 2023 në fondin pyjor e kulloso nuk kemi raste të zjarreve në fondin pyjor kombëtar.

Shuarja e këtyre zjarreve është bërë nën drejtimin e personelit të M.Z.SH.-së Durrës. Në disa parcela me pyje dhe kullota nuk është e mundur të ndërhyhet me mjetet zjarrfikëse për shkak të terrenit dhe reliefit natyror por ndërhyhet vetëm me fuqi puntore apo vullnetarë ose nga ajri. Në rastet kur zjarri është pranë fshatrave mjetet zjarrfikëse qëndrojnë në gadishmëri pranë banesave. Periudha e rënies së zjarreve në fondin pyor e kullosor zakonisht është nga 15 Qershor deri më 15 Tetor. Pavarësisht nga përcaktimi i kohës së rënies së zjarreve, nuk përjashtohet mundësia e shfaqjes së tyre dhe në periudha të tjera, gjithmonë në varësi të kushteve atmosferike dhe ndikimit nga dora e rjeriu. Ndërsa masat që merren nga Bashkia Durrës dhe Sektori i Pyjeve, përmbrrojtjen e pyjeve nga zjarri janë:

Në rast të shfaqjes së zjarreve në pyje e kullota do të organizohet i gjithë personeli pyor, emergjencat civile, Njësitë Administrative së bashku me skuadrat zjarrfikëse vullnetare të ngritura më parë në bazë fshati me mjete të ndryshme dhe do të janë të pranishme në vënd ku do të punohet përmbrrojtja e shuarjen e zjarreve.

Drejtimin për shuarjen e zjarrit në pyje dhe kullota si fillim bëhet nga punonjësit e Njësive Administrative, specialistët e pyjeve deri në mbërritjen e punonjësve të repartit të M.Z.SH-së të cilët marrin drejtimin e këtij operacioni pasi janë më të specializuar. Operacioni për shuarjen e zjarrit në pyje dhe kullota vazhdon deri në izolimin dhe shuarjen e tij. Sipas rasteve të zjarrit (rëndësisë, përhapjes) do të shfrytëzohen të gjitha institucionet si reparte ushtarake dhe institucionë shtetërore të cilat janë një burim i madh njerëzor për shuarjen e zjarreve në pyje, duke mos harruar se burimi kryesor për shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota është vetë komuniteti vendas. Bashkia Durrës, Sektori i Pyjeve pas marrjes së njoftimit përmbrrojtje së zjarrit duke u nisur nga vendi ku ka rënë zjarri, përbërtja e grumbullit pyor, rreziku i qëndrave të banuara përcakton qartë organizimin e shuarjes së zjarrit. Krahë fondit pyor që kemi në administrim do të jemi në gadishmëri dhe përmbrrojtja e zjarrit do kërkojmë ndihmë përmjetë nga institucionë të tjera.

Lëvizja e mjeteve dhe burimeve njerëzore në drejtim të vëndit ku ka rënë zjarri, piknisjen e kanë nga institucioni kur bëhet fjalë përmbrrojtja e bashkëpunim institucional, nga fshati kur bëhet fjalë përmbrrojtja e komunitetit vendas, si dhe nga subjekti privat kur bëhet fjalë përmbrrojtja e pyjet privat. Ky itenerar i lëvizjes së mjeteve dhe burimeve njerëzore do të jetë gjithmonë në bazë të konfiguracionit të terrenit. Ndërsa masat e duhura përmbrrojtja e zjarreve në pyje dhe kullota janë dhe ndërhyrjet me punime si pastrime, krasitje, rrallime në të dy anët e rrugëve kryesore dhe ato sekondare që ndodhen në brendësi të fondit pyor. Një masë tjetër që ndihmon në përmbrrojtja e zjarreve në pyje është dhe rehabilitimi i infrastrukturës rrugore në brendësi të fondit pyor e kullosor kryesisht në pyjet e fshatrave. Përmbrrojtja e ana e Bashkisë të vihet në dispozicion të sektorit të pyjeve dhe repartit të M.Z.SH.-së mjeti fadromë përmbrrojtja e rehabilitimit e infrastrukturës rrugore. Bashkia Durrës dhe Sektori i Pyjeve do të zhvillojnë takime sensibilizuese me të gjithë kryetarët e fshatrave, kryetarët e skuadrave zjarrfikëse që janë ngritur në bazë fshati, në bashkëpunim dhe me M.C.R (emergjencat civile), M.Z.SH.-në duke ju shpjeguar përmbrrojtja e madhe që kanë pyjet e kullotat dhe se nga ana jone duhet të punohet më shumë përmbrrojtja e parandalimin, luftimin, shuarjen e zjarreve kur kemi raste të rënies së tyre. Gjithashtu do të vendosen postera nëpër qëndrat e banuara në vendet më të dukshme përmbrrojtjen e pyjeve nga zjarri.

Përsa më lartë dhe në zbatim të akteve ligjore, ngelet në gjykimin tuaj miratimi i këtij drafti strategjik i cili paraprakisht është miratuar në mënyrë hierarkike nga institucioni i Bashkisë Durrës.

Faleminderit!

Konservor: A. Kapukaj

S. Molkaçi

DREJTOR

Alneida Rroshi



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË  
BASHKIA DURRËS  
DREJTORIA LIGJORE  
SEKTORI I PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr. 3736 prot

Durrës, më 18. 3. 2025

MIRATOI  
ZËVENDËSKRYETAR  
Gentian Kallmi



BASHKIA DURRËS  
DREJTORI I PËRSHPEjtë BASHKIA DURRËS



PLANI I MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE MENAXHIMIN E  
ZJARREVE NË PYJET, KULLOTAT TË BASHKISË DURRËS  
VITI 2025

## PLANI I MANAXHIMIT TË ZJARREVE NË PYJE DHE KULLOTA PËR VITIN 2025.

### Baza ligjore.

Bashkia Durrës në zbatim të Ligjit 57/2020 "Për pyjet" nen 30, pika 3. 4, 5, 6, Ligji nr.45/2019, datë 18.7.2019 "Për Mbrojtjen Civile", ligjt nr.152/2015, datë 21.12.2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", Ligjt nr.9244, datë 17.6.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore" (ndryshuar me ligjin nr.69/2013, datë 14.2.2013; nr. 131/2014, datë 2.10.2014; nr. 68/2023, datë 21.7.2023), VKM -së nr.807, datë 28.12.2023 "Për miratimin e planit kombëtar të emergjencave civile", VKM-së nr.1080, datë 22.12.2010 "Mbi rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota", VKM -së nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Bashkisë Durrës" e ndryshuar me VKM-në nr.134 datë 03.03.2021, Urdhërit nr.414, datë 25.10.2024 (i ndryshuar) të Kryetarit të Bashkisë Durrës për përditësimin e anëtarëve të Komisionit të Mbrojtjes Civile, si dhe në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore dhe shuarjen në kohë të zjarreve ("Zjarr masiv" është zjarri që zhvillohet apo tenton të zhvillohet në sipërfaqe e volume të konsiderueshme, përballimin e të cilit, përvëç forcave operacionale, mjeteve e pajisjeve që zotëron shërbimi zjarrfikës i një stacioni, kërkohet edhe pjesëmarrja për ndihmë nga stacionet zjarrfikëse të bashkive të tjera. "Zjarr me përmasa të mëdha" është zjarri që zhvillohet në sipërfaqe e volume të mëdha, përballimin e të cilit, përvëç forcave operacionale, mjeteve e pajisjeve që zotëron shërbimi zjarrfikës, kërkohet edhe pjesëmarrja, për ndihmë, e forcave e mjeteve të shërbimeve apo strukturave të tjera operuese, "Organizim i ndërhyrjes në shuarjen e zjarrit dhe shpëtim" është tërësia e masave teknikoorganizative të nevojshme, për organizimin e forcave të ndryshme, mjeteve, pajisjeve zjarrfikëse, metodave e taktilave, të cilat përdoren për ndërhyrjen në shuarjen e zjarrit, evakuimin dhe shpëtimin e jetës së njerëzve, kafshëve dhe pronës.) të mundshme në pyje e kullota dhe përballimin e situatave emergjente, si dhe të planit të masave të Bashkisë Durrës, hartohet ky plan menaxhimi si vijon:

Pregatitja e planit operativ vjetor përmbrrojtjen e pyjeve nga zjarret. Bazuar në ligjin nr 57/2020 "Për pyjet", ligjin nr 9693/2007 "Për fondon kulloso r SH" si edhe V.K.M.-së nr.1080/2012, hartohet plani operativ përmbrrojtjen e pyjeve nga zjarri. Karakteristikat e zjarreve pyjore mund të përkufizohet si një zjarr bimësie, dmth që ka si lëndë djegëse origjinën bimore, i aftë të përhapet në mënyrë autonome në zonën e pyllëzuar. Në mënyrë që të fillojë ky fenomen, është e nevojshme një ndezje, që është një furnizim i mjaftueshëm i nxehësisë përmbrrojtues të zjarrit dhe analizohet në kërkimin e shkaqave të zjarrit. Probabiliteti i ndezjes së kësaj lënde pyjore është i lidhur me karakteristikat e tij fizike, para së gjithash lagështia dhe shpërndarja e saj në hapësirë. Përhapja e zjarrit është një ngjarje dinamike e lidhur fort me kushtet mjedisore. Pjesa e përparme e flakës ka një sjellje të lidhur me faktorët predispozues që ndryshojnë në kohë dhe hapësirë dhe kushtëzojnë përhapjen e saj. Zjari pyjor është një fenomen që evoluon, karakteristikat e të cilit ndryshojnë me kalimin e kohës.

Sipas llojeve të zjarreve në pyje mund ti specifikojmë në:

- Zjarr nëntokësor ose nënsipërfaqësor.
- Zjarr sipërfaqësor ose pranë nëntokës.

- *Zjarr nē kurorat e drurëve.*
- *Zjarr i përgjithshëm ose i kombinuar.*

Të gjitha masat që merren për parandalimin e zjarreve sipas kohës kur ndërmesen dhe me cfarë qëllimi, ndahen në:

- a. Masa preventive.*
- b. Masa përgatitore.*
- c. Masa direkte.*

Masat preventive masa mbrojtje kundër zjarreve që merren vazhdimisht gjatë gjithë vittit. Kjo për shkak se njeriu është shkaktar i tyre në 99% të rasteve edhe këto masa janë të përqëndruara plotësisht ndaj njeriut. Qëllimi final është të parandalohet shkaktimi i zjarreve dhe të zvogëlohet numri i këtyre zjarreve. Në këtë kuadër këto masa janë.

Masa ligjore, mbrojtja e pyjeve/kullotave rregullohet me ligje dhe akte nënligjore ku mbrojtja e tyre është përgjegjësi e të gjithëve por edhe e pronarëve (bashkisë apo subjekteve private) si edhe subjekteve që i menaxhojnë ato.

Masat edukative, këto janë masa të cilat në vetvete përfshijnë edukimin e njerëzve dhe përdoren për të gjithë grupmoshat, megjithëse më të përdorurat janë për të rinjtë deri në moshën 18 vjeçare. Mënyrat janë nga më të ndryshmet që nga mësimet në librat shoklorë, leksione të hapura për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret, përdorimi i revistave, fletpalosjeve, rrjeteve sociale, televizionit etj.

Masa informative- propagandistike, qëllimi i tyre është për të paralajmëruar dhe informuar njerëzit për rreziqet nga paraqitja e zjarreve në pyje si edhe për të informuar se si duhet të sillemi gjatë qëndrimit në zonat pyjore. Kjo masë kombinohet edhe me atë edukative. Duke patur parasysh që masat preventive nuk e zgjidhin plotësisht problemin e mbrojtjes së pyjeve nga zjarret, është e domosdoshme marra e masave përgatitore. Këto masa kanë një natyrë të përherëshme gjatë gjithë vittit dhe përfshihen:

Zbulimi në kohë i zjarrit, transferimi i informacionit mbi zjarrin, organizimi i zjarrfiksave dhe vullnetarëve. Zbulimi në kohë i zjarrit është i një rëndësie të madhe për lokalizimin dhe fikjen shpejtë të tij. Transferimi i informacionit mbi zjarrin i kryer në mënyrë të shpejtë ka efektin e dëshiruar. Dhënia e këtij informacioni bëhet nëpërmjet telefonit apo edhe sinjalit e tjera si flamuj etj. Qytetarët të cilët zbulojnë zjarre në pyje/kullota duhet të njoftojnë në nr e tel 128 Shërbimin Zjarrfikës. Një organizim më i mirë në mënyrën e transferimit të informacionit do të jetë nëpërmjet radiove-lidhëse apo ndërtimit të rrjetit të marrje-dhënie nëpërmjet pajisjeve vëzhguese në të gjithë territorin e mbuluar me pyje. Organizimi i zjarrfikseve dhe vullnetarëve deri tek vatra e zjarrit është shumë e rëndësishme për këtë arësy duhet njoftuar menjëherë me zbulimin e zjarrit. Transporti i organizuar i zjarrfikseve dhe pajisjeve, mënyra e organizimit të tyre dhe vullnetarëve krijon premisa për menaxhim të mirë të situatës së zjarrit. Pavarësisht nga masat më të mira preventive të marra, zjarret përsëri ndodhin. Për këtë arsy nevojiten masat direkte. Këto janë masa të cilat ndërmessen gjatë kohëzgjatjes së zjarrit dhe synojnë lokalizimin dhe shuarjen e tij. Për të lokalizuar apo shuar një zjarr është e nevojshme të largohet një nga elementet nga i ashtëquajturi trekëndësh i Osborn-it, përkatësisht materiali djegës, burimi i nxehësisë apo oksigjeni.

Sipas asaj secili material ose mjet përdoret për këtë qëllim, metodat e shuarjes ndahen në:

-Shuarje e zjarrit me tokë, metoda më e vjetër e përdorur për këtë qëllim, ku materiali i tokës përdoret si izolator, pra lagon elementin oksigjen nga materiali djegës.

Toka gjithashtu vepron si një izolant i nxehësisë, përkatësisht energjia termike për djegien e drurit.

-Shuarje e zjarrit me ujë, edhe kjo një ndër metodat tradicionale në shuarjen e zjarreve. Veprimi i ujit në procesin e shuarjes është i shumëfishtë.

-Luftimi i zjarrit me zjarr, megjithëse duket si konfuze, kjo metodë është efektive por mbart në vetvete rrezik dhe kërkon persona të trajnuar dhe me përvojë. Në vartësi të takistikës për lokalizimin dhe shuarjen e zjarrit, në një distancë të caktuar nga zjarri ndizet një "zjarr i kontrolluar" (që mund të lëvizë në drejtim të kundërt ose të njëjtë me drejtimin e lëvizjes së zjarrit) i cili djeg materialin para frontit të zjarrit, kur zjarri arrin në atë sipërsfaqe, nuk ka cfarë të djegë dhe zjarri shuhet.

-Shuarje e zjarrit nga ajri (nëpërmjet aeroplanoëve është përdorur për herë të parë në vitin 1930). Në përgjithësi kjo është një metodë uji ose kimikatesh, por për shkak të specifikës është e veçuar si mëtodë e vecantë. Është metodë mjaft e shpejtë dhe efikase sidomos për rastet e terreneve malore dhe kodrinore.

-Shuarja e zjarrit me kimikate, në këtë rast përdoren kimikate të ndryshme. Kjo metodë alternohet me atë të ujit sepse në përgjithësi këto kimikate shpërbëhen nëpërmjet ujit. Llogaritet se 70% e ujit që përdoret në shuarjen e zjarreve harxhohet pa efektivitet, për këtë arsyen ujti i shtohen kimikate të ndryshme të cilat pëmirësojnë efektin e shuarjes së zjarrit.

-Shuarje e zjarrit me eksploziv, përdoret kryesisht si metodë ndihmëse. Kryesisht për të trezuar pemë, gërmim kanalesh, krijim pengeshash etj. Në rastet e shpërthimeve krijuhet "re e pluhurit" e cila ul përqindjen e oksigjenit në ajër rrjedhimisht zjarri ul intensitetin ose shuhet plotësisht.

## VEPRIMET KRYESORE GJATË ZBULIMIT TË ZJARRIT NË PYJE E KULLOTA.

Përkufizime:

"Rrezik zjarri" është situata e krijuar nga akumulimi i faktorëve që nxitin mundësinë e nisjes së zjarrit dhe zhvillimit të tij.

"Sisteme të diktim-sinjalizimit" janë pajisje që diktojnë, sinjalizojnë shfaqjen e tymit, gazrave dhe zjarrit.

"Shërbimi vullnetar i mbrojtjes nga zjarri" është organizimi i strukturës vullnetare për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, nga organet e njësive e qeverisjes vendore, nga personat juridikë, që kryejnë veprimtaritë e tyre në Republikën e Shqipërisë, nga institucionet dhe agjencitë shtetërore, të cilat kanë përgjegjësi për administrimin e pasurive shtetërore me rrezikshmëri nga zjarri.

"Mbrojtja e pyjeve dhe e tokës pyjore" është veprimtaria për parandalimin e degradimit, përtëritjen, ruajtjen dhe pëmirësimin e burimeve pyjore e jopyjore bashkëshoqëruese dhe të mjedisit pyjor nga faktorët njerëzorë e natyrorë.

"Pyll komunal" është pylli në pronësi apo në përdorim të organeve të qeverisjes vendore.

"Mbrojtja e pyjeve dhe e tokës pyjore" është veprimtaria për parandalimin e degradimit, përtëritjen, ruajtjen dhe pëmirësimin e pyjeve të burimeve pyjore e jopyjore bashkëshoqëruese dhe të mjedisit pyjor nga faktorët njerëzorë e natyrorë. Detyrë qytetare e edo individi, në rast se zbulon zjarr në pyll/kullotë, është që të njoftojë sa më shpëjt të jetë e mundur institucionet përgjegjëse. Nga shpejtësia e informimit, saktësia dhe përmajtja varet suksesit i aksionit të shuajtjes së zjarrit. Në rast se në fondin pyjor ose në një pjesë

pylli dhe nē shkurre bie zjarr, organet e sherbimit pyjor, organet e njësive të qeverisjes vendore, qđo subjekt shtetëror a privat, njësi apo repart ushtarak, shkollë, institucion publik e privat, si dhe qđo shtetas kanë detyrë të njoftojnë dhe të marrin pjesë pér shuarjen e tij.

Hapat qđ duhet të ndërmerrën janë:

Telefononi nr.128 i Shërbimit Zjarrfikës. Prezantoni veten me emër e mbiemr. Tregoni se ku jeni (vendndodhjen e saktë). Tregoni vendndodhjen e zjarrit (duke dhënë pikat orjentuese sa me te sakta, emrin e vendit, vendbanimit më të afërt apo objekte te njobura). Tregoni llojin e bimësise qđ po digjet (dru, shkurre, bar etj). Nëse vëreni diçka të dyshimtë afërt vatrës së zjarrit, domethënë automjet mundohuni të shënoni targën apo ta mbani mend.

Nëse vlerësoni se mund të shuan zjarrin me mjete rrëthanore atëherë ndërhyni, ne të kundërt largohuni nē një distancë të sigurt. Me qëllim qđ të kuptoheni me personin nē telefon jeni të lutur të flismi qartë dhe ngadalë. Informacioni i dhënë nē këtë mënyrë është i saktë dhe përmban të gjitha elementet e nevojshme pér përcaktimin e vatrës së zjarrit, lloji i materialit djegës, nëse zjarri ka qënë i qëllimshëm etj. Pavarësisht masave të ndërmarra përgjatë viteve, ende theksi nga të gjithë aktorët adresohet tek mbrojtja e pyjeve, duke u përbledhur nē një kërkësë të thjeshtë:

**"Pylin vetëm mbroje, sepse rritet vetë!"**. Në përgjigje të kësaj ftesë duke konsideruar statusin e pyjeve si pasuri kombëtarë, edhe reagimi duhet të jetë i fokusuar nē politiken e mbrojtjes dhe forcimit të masave ndëshkuese, duke shpallur si "armikun" nr. I zjarrin. Në këtë kontekst, është i nevojshëm aktualizimi i masave sinjalizuese dhe parandaluese pér mbrojtjen e pyjeve nga zjarri. Kjo kërkon anagazhim dhe koordinim nga të gjithë aktorët: qeverisja qendrore, qeverisja vendore, sipërmarrja, komuniteti, qytetari.

Pér të ndjekur këtë qëllim, strategjia e planit bazohet nē tre komponentët e konsoliduar dhe të përhapur nē nivel kombëtar dhe evropian: parashikimi, parandalimi dhe lufta aktive kundër zjarreve pyjore, krahas së cilës është edhe ai i trainimit dhe edukimit mjedorë.

### **PARASHIKIMI.**

Aftësia pér të parashikuar zonat e territorit dhe periudhat e vitit nē të cilat ka më shumë të ngjarë të ndodhë një zjarr është thelbësore pér të parandaluar fillimin ose përhapjen e tij. Në zbatim të dispozitave të legjislativit, qëllimi i parë i përgjithshëm i planit ka të bëjë pikërisht me përmirësimin e hartografisë së Rrezikut nga Zjarri nē Pyje. Me objektiv specifik të identifikimit të zonave nē rrezik dhe rrezik më të madh, hartimin e grafikëve të rinj të rrezikut nga zjarret nē pyje. Një aspekt tjetër i rëndësishëm i parashikimit, ka të bëjë me identifikimin e periudhave të vitit nē të cilin rreziku është më i madh, kuptohet gjithmonë si probabiliteti i ndodhjes së zjarreve nē pyje.

### **PARANDALIMI.**

Në kontekstin e përvjës së fituar pér më shumë se tridhjetë vjet, parandalimi është thelbi operacional dhe konceptual i luftimit të zjarrit nē pyje. Termi parandalim nē fakt kuptohet nē një kuptim të zgjeruar, i cili shkon nga kujdesi pér zonën e pyllëzuar pér kontrollin e përdoruesve të saj, si përdorues të zakonshëm ashtu edhe të rastit, sic mund të janë kalimtare/turiste gjithmonë me vëmendje të veçantë nē zonat urbane-pyjore dhe bujqësore-pyjore. Pér më tepër, edhe punimet mbështetëse nē infrastrukturën pyjore janë veprimë parandaluese qđ konsistonë nē zbatimin e veprimeve qđ synojnë zvogëlimin e shkaqeve dhe potencialin pér shkaktimin, si dhe ndërrhyrjet qđ synojnë zbutjen e dëmit pasues. Objektivat specifikkë: siguria e formacioneve pyjore me potencialin më të madh pirologjik, të cilat kryhen përmes aktivitetave parandaluese kontrollin e burimeve kryesore

të agjentëve shkakësorë me origjinë antropogjene (aktiviteti bujqësor dhe frekuentimi i turistëve), të cilat do të merren përmes monitorimit të zakonshëm të territorit dhe kontaktit me popullatën nga stafi i strukturave pyjore dhe Njësive Administrative ku shtrihen zonat pyjore. Objektivi i dytë i përgjithshëm është minimizimi i dëmit të shkaktuar nga zjarret, të cilat varen në mënyrë rigorozë dhe unike nga mundësia e operacioneve të shuarjes efikase/efektive, duke pasur si faktor kryesor shkallën e zhdukjes.

### **LUFTA AKTIVE.**

Luftha aktive kundër zjarreve në pyje është përgjegjësi e Shërbimit të Zjarrfikjes dhe Mbrojtjes Civile përmes Sektorit të Pyjeve, Njësive Administrative përkatëse dhe Vullnetarëve të Mbrojtjes së Pyjeve nga Zjarri. Mënyrat e funksionimit të strukturës kundër zjarrit dhe lidhja me strukturat pyjore janë të detajuara në këtë plan. Brënda kornizës së planit, nuk janë zhvilluar veprime dhe qëllime në lidhje me luftën aktive, të cilat nuk kanë të bëjnë me strukturën që propozon plani, sidqoftë duhet shtuar se veprimi i ekipeve të ndërhyrjes, të karakterizuara nga një shpërndarje e përhapur në territor dhe nga një furnizim sa më të mirë të pajisjeve nga Njësitë Administrative në lidhje me njojen e territorit fizik dhe të pyllëzuar.

### **TRAJNIM, INFORMIM DHE EDUKIM MJEDISOR.**

Trajnim teknik dhe trajnimi i personelit të përfshirë në shuarjen e zjarreve në pyje (zjarrfikës të përhershëm dhe vullnetarët) kryhet në autonomi të plotë, nga Serbimi Zjarrfikes, prandaj edhe ky komponent nuk përfshihet në detaje midis objektivave specifikë të Planit, por supozohet në kornizën logjike si një parakusht i jashtëm. Nga ana tjetër, në lidhje me aspektet e informacionit dhe edukimit mjedisor, nuk parashikohen ndërhyrje dhe objektiva shtesë krahasuar me aktivitetet e zakonshme tashmë të vendosura; në mjedisin shkollor, në banorë të zonave, blegtorë etj. Kjo e kryer me intensitet dhe frekuencë të ndryshme. Përveç këtyre aktivitetave, duhet të mbahet mend veprimi sistematik i monitorimit të territorit dhe kontaktit me popullatën nga Njësitë Administrative. Është vënë re se reklamimi i vazhdueshëm, përmes mediave, i ngjarjeve pirogjene që kanë ndodhur ose komunikimi rasteve me rrezik nga zjarri, ka çuar në rezultate të kundërtë me pritet, me një rritje të ngjarjeve dashakeqe pas fushatave që synojnë rritjen e ndërgjegjësimit të publikut.

Për të parandaluar zjarret të cilat siç dihet varen pothuajse ekskluzivisht nga shkaqet njerëzore, nevojitet vetëdijësim që synon respektimin e pyllit, shmangjen e qëndrimeve ose veprimeve të rrezikshme dhe për këtë arsy bashkëpunimin aktiv në mbrojtjen e trashëgimisë pyjore. Këto koncepte dhe vlera duken larg të qenit pjesë e ndërgjegjes së popullatës së zonës pyjore, kjo duket edhe në traditat e vullnetarizmit për luftën kundër zjarreve, në të gjitha Njësitë Administrative, dhe në fshatra të ndryshme ku duhet të ekzistonë vërtet grupet vullnetare të mbrojtjes së pyjeve nga zjarri dhe të jenë aktivë në cdo rast.

Informacioni i saktë në rastin e shfaqjes së zjarrit është sigurisht thelbësor, kur jep indikacione të qarta, shmanget zgjerimin ose ekzagjerimin e problemit të zjarrit në pyje. Rëndësia e një përdorimi të ekuilibruar, të kujdesshëm dhe të matur të iniciativave propagandistike kundër zjarreve në pyje është konfirmuar dhe nuk konsiderohet e nevojshme të planifikoni aktivitete të mëtejshme në këtë drejtim brënda fushës së këtij Plani.

### **MONITORIMI DHE EKZEKUTIMI**

Monitorimi në lidhje me ekzekutimin e punimeve dhe strukturën mirëmbajtëse do të kryhet vazhdimisht gjatë gjithë kohës, nëpërmjet punës për mbledhjen e të dhënave dhe gjoreferimin e tyre. Punët e realizuar do të ndiqen në vazhdimësi.

### **MONITORIMI I IMPAKTIT**

Monitorimi i impaktit është relativ dhe ka të bëjë me efektet dhe veprimet e planit mbi ndërhyrjet në zonat e rrezikut. Impakti do të ketë të bëjë me dy vlerësimë vjetore së pari me numrin e zjarreve pra trendin e tyre në përgjithësi, kohën e fikjes së tyre dhe reagimin ndaj tyre. Vlerësimin e masave të marra në funksion të sa më sipër sygjerohet të kryhet analizimi i të dhënave kryesish mbi baza territorial /Ekonomive Pyjore/ Njësive Administrative perpunimi i tyre duke synuar GIS do të lejojë që të vlerësohet efektiviteti i i përgjithshëm i veprimeve/aktiviteteve të planit për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri.

### **VEPRIMET NË RASTET E SHFAQJES SË ZJARRIT NË FONDIN PYJOR**

Bashkia Durrës me strukturat e saj, M.Z.SH, Njësitë Administrative, sektorët Pyjeve, Bujqësisë dhe Mbrotjtës Civile, në zbatim të dispozitave ligjore si më sipër, për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në fondin pyjor/kullosor në administrim të saj parashikon marrjen e masave organizative si më poshtë:

- Të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë Durrës të organizojnë/riorganizojnë "Shërbimin vullnetar të mbrojtjes nga zjarri". Këto skuadra përbëhen nga 6 anëtarë. Skuadra e "Shërbimit vullnetar të mbrojtjes nga zjarri" do të jenë strukturat e para që së bashku me strukturat e tjera do të mbajnë nën kontroll zjarrin deri në mbërritjen e forcave dhe mjeteve.

- Struktura Njësitë Vullnetare për shuarje Zjarri/inspektorët e pyjeve, nëpërmjet sektorit të Mbrotjtës Civile, Mbrotjtës nga Zjarri dhe Shpëtimi do të trajnohen dhe kualifikohen përmbytësuar e shuarjes së zjarrit në pyje/kullota.

- Bashkia Durrës nëpërmjet strukturave të saj sektorit të Mjedisit, Pyjeve, Bujqësisë, Mbrotjtës Civile dhe M.Z.SH, shoqatave të ndryshme etj, do të organizojë biseda me komunitetin e zonave pyjore, nxënësve të shkollave në këto zona mbi sensibilizimin e opinionit përmbytësuar e mbrojtjes së pyjeve/kullotave:



Inspektorët e Njësive Administrative:


1. Njofton menjëherë në numrin e telefonit 128 Shërbimin Zjarrfikës (MZSH) dhe/ose nr.126 ose 129 të Policisë së Shtetit ose nr 122 pa pagesë Thirrjeve Emergjente ku prezanton veten me emër e mbiemër, tregon se ku jeni (vendndodhjen e saktë), tregon venndodhjen e zjarrit (duke dhënë pikat orientuese më të sakta, emrin e vendit, vendbanimit më të afërt apo objekte të njoitura), tregoni llojin e bimësise që po digjet (dru, shkurre, bar etj).
2. Njofton Administratorin e NJ.A. ku ndodhet vatra e zjarrit.
3. Nëse vlerësoni se mund të shuan zjarrin me njete rrëthanore atëhere ndërhyjni, në të kundërt largohuni në një distancë të sigurt.


- Në rastet e shfaqjes së zjarrit në zonë pyjore/kullosore, dhe marrjen e njoftimit, Administratori i NJA, kryen veprimet si më poshtë:

1. Njofton sektorin e Pyjeve dhe Kullotave dhe Shërbimin Zjarrfikës (M.Z.SH.).
2. Njofton Strukturën Njësitë Vullnetare (në bazë fshati) për shuarje Zjarri e cila është ngritur dhe funksionon pranë Njësitet Administrative në fjalë.
3. Të gjithë bashkë organizohen për shuarjen e zjarrit ose lokalizimin e tij deri në mbërritjen e forcave të specializuar të mbrojtjes nga zjarri.

Më poshtë janë hartat e fondit pyjor dhe kullosor për secilin fshat të Bashkisë Durrës.







N 1:10 000  
BASHKIA DURRÈS  
2009 JUBE


11 125 131  
Kilometri





N 1:5 000  
BASHKIA DURRÈS  
2005 KAMERAS

11 125 131  
Kilometri









N 1:10 000  
BASHKIA DURRËS  
2591 MANSKURI



0 0,25 0,5 Kilometri



N 1:13 000  
BASHKIA DURRËS  
1574 NB FRUTORE

0 0,25 0 Kilometri





BASHKIA DURRËS  
3236 RRROMANAT

N 1:12 000


05.025 0 05 Kilometri



BASHKIA DURRËS  
3241 RRUSHKULL


N 1:11 000

05.025 0 05 Kilometri




N 1:11 000 BASHKIA DURRÈS  
3365 SHETAJ

0,0 0,25 0,5 Kilometri




N 1:7 000 BASHKIA DURRÈS  
3383 SHKALLE

0,0 0,25 0,5 Kilometri



BASHKIA DURRËS  
3385 SHKALLNUR



### **1. Për menaxhimin e zjarreve në pyje dhe kullota u përcaktuan:**

Parcelat pyjore dhe kullosore me rrezikshmëri zjarri të lartë si dhe periudhat e rënies së zjarreve në fondin pyjor e kullostor që administron Bashkia Durrës, duke patur parasysh përvojën e viteve të mëparme, zonat që paraqesin rrezik zjarri janë:

#### **Njësia Administrative Ishëm.**

##### **Përfshin ekonomitë pyjore Rrotull, Koder - Reke, dhe Kuraten.**

- Kepi i Rodonit parcelat nr. 1 - 7 ekonomia pyjore Rrotull dhe 77 - 85 ekonomia pyjore Kodër - Rekë.
- Drraç - Shetaj, parcelat nr. 8 - 17 ekonomia pyjore Rrotull dhe 60 - 76 ekonomia pyjore Kodër - Rekë.
- Fushë Drraç - Shënpjetër, parcelat 66 - 70 dhe 18 - 36, ekonomia pyjore Rrotull.
- Ishëm, Likmetaj, Kërtushaj parcelat me pishë me nr. 1 deri 22, ekonomia pyjore Kodër - Rekë.
- Kuratën - Senavdi (parcelat me nr 24 deri ne 34) ekonomia pyjore Kuratën.
- Ndërhyhet me mjete zjarrfikëse së objektin Shënpjetër (parcelat me pishë) dhe ka burime uji.

Në objekte të tjera ndërhyhet me zjarrfikëse pjesërisht vetëm në afërsi të fshatrave. Periudha e rënies së zjarreve në këto objekte rrezikon nga 15 Qershori deri më 15 Shtator.

Pavarisht nga përcaktimi i kohës së rënies së zjarreve në objekte të mësipërmë, nuk përjashtohet mundësia e shfaqies së tyre dhe në periudhe kohe tjetër, gjithmonë në varësi të kushteve atmosferike.

#### **Njësia Administrative Manëz.**

##### **Përfshin 1 (një), ekonomi pyjore, Kodër - Lac.**

Objektet kryesore të kësaj zone që rrezikohen nga zjarri janë:

- Objekti, Kodër - Lac parcelat 19 - 20, dhe 25 deri 30 dhe në këtë objekt nuk ndërhyhet me mjete zjarrfikëse përmungesë të rrjetit rrugor.
- Objekti, Gryka e Shkallës - Gryka e Minierës parcelat 32 - 49, ndërhyhet pjesërisht me mjete zjarrfikëse vetëm në afërsi të fshatrave.
- Objekti, Gryka e Tarinit Parcelat 8 - 16 ku nuk ndërhyhet me zjarrfikëse pasi nuk ka rrjet rrugor.

Në këtë zonë ka shumë objekte me rrezikshmëri zjarri, kjo dhe nga përvoja e viteve të mëparshme.

#### **Njësia Administrative Sukth.**

##### **Përfshin 1 (një), ekonomi pyjore Rrushkull.**

Objektet kryesore të kësaj zone që rrezikohen nga zjarri janë:

Objektet me rrezikshmëri zjarri janë parcelat nr. 36, 37, 38, 39, ndërhyhet me zjarrfikëse dhe ka burime uji.

#### **Njësia Administrative Katund i Ri.**

##### **Përfshin një pjesë të ekonomisë pyjore Shijak - Maminas.**

Objektet kryesore te kësaj zone që rrezikohen nga zjarri janë:

Bisht - Kamëz, veçanërisht objekti i kashtës së kënetës zonë turistike. Zjarri në këtë objekt rrezikon në periudhën Qershori-Shtator. Është e mundur të ndërhyhet me mjete zjarrfikëse, dhe ka burime uji. Gjithashtu përmësuar këtë zonë rrezikshmëri zjarri ka dhe një objekt Bisht - Kamëz, parcelat me pishë ku zjarri rrezikon në periudhen Qershori - Shtator (zonë turistike).

#### **Njësia Administrative Rrashbull**

##### **Përfshin një pjesë të ekonomisë pyjore Shijak - Maminas.**

Objektet kryesore të kësaj zone që rrezikohen nga zjarri janë:

Parcelat 9/b, 9/c, 16, 26/a, 27, 28/a, 28/b janë parcela me trezikhmëri zjarri dhe  
në këtë kohë nuk ka.  
**Njësia Administrative Nr.1**  
Përfshtin pjesën me problem për zjarret në kodrën e Currilave dhe këtu ndërhyhet me  
mjete zjarrfikëse si dhe ka burime uji.

#### **Njësia Administrative Nr.4**

Përfshtin pjesën Kallmit në Durrës që nga përvaja e viteve të kaluara ka patur trezikhmëri zjarri dhe shfaqje zjarri, dhe këtu ndërhyhet me mjete zjarrfikëse si dhe ka burime uji.

#### **2. Masat dhe aktivitetet që do të merren për parandalimin e zjarreve në pyje dhe kullota .**

Masat që merr Bashkia Durres, Sektori Pyjor për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri janë:

- Kordinim me Komisionin e Mbrojtjes Civile në Bashkinë e Durrësit si dhe me Sektorin e Mbrojtjes Civile, pranë Drejtorisë Shërbimeve për situatat emergjente si zjarre që përfshijnë fondin pyjor.
- Kordinim me Sektorin e Bujqësisë në situatat e zjarreve në sipërsaqe bujqësore.
- Ngritja e sistemit të vrojtimit sinjalizimit, me vrojtues zjarri sipas afateve të përcaktuara në aktet ligjore.
- Ngritja e njësive vullnetare të shuarjes së zjarreve në bazë fshatash, njësie e bashkie.
- Sensibilizimi i opinionit publik me vendosje posterash të M.N.Z si dhe takime të vazhdueshme me komunitetin, pushtetin vendor, sensibilizim në media të shkruar dhe vizive lokale.
- Sensibilizimi i bletarrëve si dhe bujqërve për ndalimin e praktikave të tymosjes së bletëve si dhe djegies së stërnishteve.
- Ndalimi i çdo praktike zjarri në largësi 200 – 300 m ndezja e zjarreve në pyje e kullota ose jashtë tyre.
- Ngritja e pikave të vrojtimit dhe paisja me bazë materiale të tyre si lopata, kazma, shata, kallo ferrash etj.
- Efektiviteti në një shkallë më të lartë të telefonisë celulare. Hartimi i një skeme lajmërimi për cdo njësi të qeverisjes vendore.

#### **3. Situatat emergjente dhe mbledhja e Komisionit të Mbrojtjes Civile, në nivel vendor dhe të Prefekturës.**

K.M.C. në nivel vendor, në fillim të sezonit të thatësirave si dhe të sezonit të verës me ngritjen e temperaturave të larta kryhen mbledhjen e rradhës. Kjo mbledhje kërkohet me iniciativën e Sektorit të Pyjeve. Sektori i Mbrojtjes Civile luan rolin e sekretarit teknik. Mbledhja kryesohet nga kryetari i bashkisë Durrës në të cilën diskutohen masat e marra për parandalimin dhe mbrojtjen e pyjeve. Ky lloj aktivitet është në kushte të zakonshme dhe vjetore. Në rastet e zjarreve dhe eskalimit të situatave, KMC mblidhet duke diskutuar për situatën në vend. Në mbledhje marrin pjesë të gjitha strukturat pjesmarrëse.

K.M.C. në nivel Prefekturë mblidhet me kërkësë të qarkut Durrës në të cilën marrin pjesë të gjitha bashkitë e Prefekturës, Policia, MZSH-të apo institucionet e ndryshme qëndrore dhe vendore. Diskutohen masat e marra si dhe detyrimet ligjore për secilin aktor. Kërkësat për bashkëpunime apo situata eskalimit të fatkeqësive në rastin konkret zjarreve në bashki.

#### **4. Identifikimi i mjeteve, paisjeve dhe burimeve njerëzore që mund të vihen në dizpozicion, përluftën kundër zjarreve në pyje dhe mënyrën e aktivizimit të tyre.**

Në rast të shfaqes së zjarrve në pyje e kullota do të shfrytezohet i gjithë personeli pyjor dhe shërbimi civil i njësive administrative për izolimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje e kullota.

Do të kërkohet ndërhyrje M.Z.Sh-së që të vejë ne dispozicion mjetet zjarrfikëse së bashku me efektivin e saj si dhe M.C.R (emergjencave civile). Do të shfrytëzohen të gjitha institucionet si shkolla, reparte ushtarake, të cilat janë një burim i madh njerëzor për shuarjen

Parcelat 9/b, 9/c, 16, 26/a, 27, 28/a, 28/b janë parcela me rrezikshmëri zjarri dhe pjesërisht ndërhyhet me mjete zjarrfikëse. Burime uji nuk ka.

#### **Njësia Administrative Nr.1**

Përfshin pjesën me problem për zjarret në kodrën e Currilave dhe këtu ndërhyhet me mjete zjarrfikëse si dhe ka burime uji.

#### **Njësia Administrative Nr.4**

Përfshin pjesën Kallmit në Durrës që nga përvoja e viteve të kaluara ka patur rrezik zjarri dhe shfaqje zjarri, dhe këtu ndërhyhet me mjete zjarrfikëse si dhe ka burime uji.

#### **2. Masat dhe aktivitetet që do të merren për parandalimin e zjarreve në pyje dhe kullota .**

Masat që merr Bashkia Durres, Sektori Pyor për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri janë:

- Kordinim me Komisionin e Mbrojtjes Civile në Bashkinë e Durrësit si dhe me Sektorin e Mbrojtjes Civile, pranë Drejtorisë Shërbimeve për situatat emergjente si zjarre që përfshijnë fondin pyor.
- Kordinim me Sektorin e Bujqësisë në situatat e zjarreve në sipërsaqe bujqësore.
- Ngritja e sistemit të vrojtimit sinjalizimit, me vrojtues zjarri sipas afateve të përcaktuara në aktet ligjore.
- Ngritja e njësive vullnetare të shuarjes së zjarreve në bazë fshatrash, njësie e bashkie.
- Sensibilizimi i opinionit publik me vendosje posterash të M.N.Z si dhe takime të vazhdueshme me komunitetin, pushtetin vendor, sensibilizim në media të shkruar dhe vizive lokale.
- Sensibilizimi i bletarrëve si dhe bujqërve për ndalimin e praktikave të tymosjes së bletëve si dhe djegies së stërnishurve.
- Ndalimi i çdo praktike zjarri në largësi 200 – 300 m ndezja e zjarreve në pyje e kullota ose jashtë tyre.
- Ngritja e pikave të vrojtimit dhe paisja me bazë materiale të tyre si lopata, kazma, shata, kallo ferrash etj.
- Efektiviteti në një shkallë më të lartë të telefonisë celulare. Hartimi i një skeme lajmërimi për cdo njësi të qeverisjes vendore.

#### **3. Situatat emergjente dhe mbledhja e Komisionit të Mbrojtjes Civile, në nivel vendor dhe të Prefekturës.**

K.M.C. në nivel vendor, në fillim të sezonit të thatësirave si dhe të sezonit të verës me ngritjen e temperaturave të larta kryhen mbledhjen e rradhës. Kjo mbledhje kërkohet me iniciativën e Sektorit të Pyjeve. Sektori i Mbrojtjes Civile luan rolin e sekretarit teknik. Mbledhja kryesohet nga kryetari i bashkisë Durrës në të cilën diskutohen masat e marra për parandalimin dhe mbrojtjen e pyjeve. Ky lloj aktivitet është në kushte të zakonshme dhe vjetore. Në rastet e zjarreve dhe eskalimit të situatave, KMC mblidhet duke diskutuar për situatën në vend. Në mbledhje marrin pjesë të gjitha strukturat pjesmarrëse.

K.M.C. në nivel Prefekturë mblidhet me kërkësë të Prefektit të qarkut Durrës në të cilën marrin pjesë të gjitha bashkitë e Prefekturës, Policia, MZSH-të apo institucionet e ndryshme qëndrore dhe vendore. Diskutohen masat e marra si dhe detyrimet ligjore për secilin aktor. Kërkosat për bashkëpunime apo situata eskalimit të fatkeqësive në rastin konkret zjarreve në bashki.

#### **4. Identifikimi i mjeteve, paisjeve dhe burimeve njerëzore që mund të vihen në dizpozion, për luftën kundër zjarreve në pyje dhe mënyrën e aktivizimit të tyre.**

Në rast të shfaqes së zjarrve në pyje e kullota do të shfrytezohet i gjithë personeli pyor dhe shërbimi civil i njësive administrative për izolimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje e kullota.

Do të kërkohet ndërhyrje M.Z.Sh-së që të vejë ne dispozicion mjetet zjarrfikëse së bashku me efektivin e saj si dhe M.C.R (emergjencave civile). Do të shfrytëzoher të gjitha institucionet si shkolla, reparte ushtarake, të cilat janë një burim i madh njerëzor për shuarjen

e zjarreve në pyje. Një kujdes të vecant si burim kryesor për M.Z.Sh-në është komuniteti vendas.

#### **5. Përcaktimi i intinerarit që do të ndjekin mjetet dhe burimet njerëzore në zonën pyjore më të rrezikuara nga zjarri sidomos për parqet kombëtare dhe zonat e mbrojtura.**

Bashkia Durrës, Sektori Pyjor në planin ose programin e punës së saj përcakton qartë organizimin e saj si në zbatimin e skemës së lajmërimit ashtu dhe në organizimin e shuarjes së zjarrit. Zonat e mbrojtura do të përgjigjen për mbrojtjen e pyjeve të kësaj zone nga zjarri. Intinerari i lëvizjes së mjeteve dhe burimeve njerëzore piknisjen e saj e ka nga institucioni ku bëhet fjalë për bashkëpunim institucional dhe nga fshati. Ky intinerar i lëvizjes së mjeteve dhe burimeve njerëzore do të jetë gjithmonë në bazë të konfiguracionit të terrenit. Për zonën pyjore të Rushkullit si zonë e mbrojtur të ngrihet sistemi i vrojtim-sinjalizimit si dhe të merren të gjitha masat e duhura për këtë problem.

#### **6. Masat Teknike për parandalimin e zjarreve, operacionet silvio-kulturale dhe ato të mirembajtjes për kontrollin e sasisë dhe gjëndjes së vegjetacionit .**

Ndër masat e duhura për parandalimin e zjarreve në pyje dhe kullota kërkohen investime në drejtim të pastrimit në të dy anët e rrugëve kryesore dhe ato sekondare që ndodhen në brendësi të fondit pyjor. Gjithashtu të shikohet mundësia e mirembajtjes me pastrime të koridoreve ekzistuese si dhe të shihet mundësia e çeljes së koridoreve të reja dhe ndërhyrja me pastrime anës rrugëve dhe të parcelave pyjore.

#### **7. Aktivitetet e trajnimit dhe informimit të publikut për dëmet që shkaktojnë zjarret me mediat vizive dhe të shkruara në nivel lokal.**

Bashkia Durres, Sektori Pyjor të zhvillojë një seminar me pjesmarrjen e strukturave përkatëse të M.Z.Sh.-së dhe M.C.R (Emergjencat civile) për sensibilizimin e strukturave përkatëse për rëndësinë e madhe që kanë mbrojtja e pyjeve nga zjarret. Ky seminar të pasqyrohet dhe në media lokale vizive dhe të shkruar, kjo vjen dhe nga përvoja e viteve të kaluara. Herë pas here do të shihet mundësia e kronikave televizive si dhe artikujve të shkruar në gazeta lokale apo qëndrore për të sensibilizuar opinionin publik. Gjithashtu të bëhen posterë të ndryshme ku të pasqyrohet qartë fushata për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri, dhe këto të vendosen nëpër qëndrat e banuara në vëndet më të dukshme. Do të merret takim në edo Njësi Administrative për të bërë të qartë rëndësinë e madhe që ka mbrojtja e Pyjeve nga zjarri.

#### **8. Plani i detajuar i nevojave financiare për përballimin e sezonit të zjarreve.**

Për përballimin e sezonit të verës, periudhë kjo që karakterizohet me zjarre në fondin pyjor dhe kulloso duhen fonde të mjaftueshme që ky problem për këtë sezon të jetë nën kontroll të plotë nga sektori pyjor, prandaj kërkohen fonde për :Ngritjen e sistemit të vrojtim-sinjalizimit me vrojtues zjarri për periudhën 15 Qershor deri më 15 Tetor 2024. Fondi pyjor i Bashkisë së Durrësit është i ndarë në 7(shtatë) Njësi Administrative ku gjënden zona pyjore me rrezikshmëri zjarri në të cilat duhet të punojnë jo më pak se 1(një) vrojtues për njësi administrative në fondin pyjor.

Për sensibilizimin e opinionit publik nëpërmjet mediave të shkruara dhe asaj vizive, bërjen e posterave të ndryshme për ruajtjen e pyjeve nga zjarri si dhe spote publicitare (logistike, shpenzime operative , bazë materiale). Për nevoja urgjente të planifikohen fonde për makina të tjera që mund të vihen në dispozicion për transportin e burimeve njerëzore.

#### **9. Struktura e ndërtuar për njoftimin dhe paralajmërimin e hershëm të zjarreve në pyje kullota për vitin 2025.**

Tabelat bashkëngjitur.

Konceptor: A.Kapidani.


Konfirmor: A.Rroshi.

Nr kopje: 3


Dati: 17.03.2025

**SKEMA E LAJMËRIMIT PËR RASTE ZJARRESHI VITI 2025**

**NJËSIA ADMINISTRATIVE SUKTH**



**SKEMA E LAJMËRIMIT PËR RASTE ZJARRESH VITI 2025**



## SKEMA E LAJMËRIMIT PËR RASTE ZIARRESH VITI 2025

### NJESIA ADMINISTRATIVE MANEZ

- Njësia Administrative Manez
- Skuadrat e shtatrave
- Kryetarët e shtatrave
- Mbrotja Civile
- Hir Beqa, Cel.0673577771
- Fabian Kuriti, Cel.0699226998
- Komuniteti

### Administratori i Njësies Administrative Manez

Muharrem Sula  
067 269 3422  
068 202 0316

### Sektori i Pyjeve

Arian Kapidani 068 52 18 400  
Serdi Maksuti 068 32 75 268  
Sektori i Mbrotjes Civile  
Jetmir Manga 069 36 06 222  
Andri Cerri 068 52 00 696  
Sektori i Bujqësisë  
Etleva Velçani 067 74 97 321

### Drejtoria

Ligiore  
Almeida Roshi  
0692022933

### Prefektura

Sekretaria  
052223559

### Nënkrtyetari

Renis Mullaj  
0675770559

### IKMT Artan Greva

0683546626  
Inspektori i rendit për zonën  
Nr. Tel. 129

### M.Z.SH

Rep. Zjarrfikes Tel. 0522233333  
dhe Nr.128  
Zyra Tel.052223218  
069 4115900 SHEFI

### Zyra e Emergjencave Civile

Prefekturë  
Romario Meta  
0688451199

SKEMA E LAJMËRIMIT PËR RASTE ZJARRESH VITI 2025

**NJESIA ADMINISTRATIVE RRASHBULL**

- Njësia Administrative RRashbull
  - Skuadrat e Ishatrave
  - Kryetarët e Ishatrave
  - Mbrojtja Civile
  - Behar Xheju 06747783001
  - Komuniteti

Administratori i Njësise  
Administrative RRashbull  
Albert Bukaçi  
068 29 65 510

Sektori i Pyjeve  
Arian Kapidani 068 52 18 400  
Serdi Maksuti 068 32 75 268  
Sektori i Mbrojtjes Civile  
Jetfir Manga 069 36 06 222  
Andri Cerrri 068 52 00 696  
Sektori i Bujqësisë  
Eltleva Velçani 067 74 97 321

Prefektura  
Nënkyryetari  
Renis Mullaj  
0675770559  
Drejtoria  
Ligjore  
Almeida Roshi  
0692022933

**IKMT Arian Greva**  
0683546626  
Inspektorë i rendit për zonën  
Nr. Tel. 129

M.Z.SH  
Rep. Zjarrfikes Tel. 052223333  
dhe Nr.128  
Zyra Tel.052223218  
069 4115900 SHEFI

Zyra e Emergjencave Civile  
Prefekturë  
Romario Meta  
0688451199

## **SKEMA E LAJMËRIMIT PËR RASTE ZJARRESH VITI 2025**

### **NJESIA ADMINISTRATIVE KATUND I RI**

- Njësia Administrative Katund i ri
- Skuadrat e fshatrave
- Kryetarët e fshatrave
- Mbrotja Civile
- Myslim Gjergji 0692008998
- Komuniteti

**Administrator i Njësisë  
Administrative Katund i Ri**

Edition Prepi  
0693064490

Sektori i Pyjeve  
Arian Kapidani 068 52 18 400  
Serdi Maksuti 068 32 75 268  
Sektori i Mbrotjes Civile  
Jetlir Manga 069 36 06 222  
Andri Cerri 068 52 00 696  
Sektori i Bujqësisë  
Elleva Velcani 067 74 97 321

**Drejtoria Ligjore**  
Almeida Kroshi  
0692022933

**Prefektura**  
Sekretaria  
052223559

**IKMT Artan Greva**  
0683546626  
Inspektor i rendit për zonën  
Nr. Tel. 129

**M.Z.SH**  
Rep. Zjarrfikës Tel. 052223333  
dhe Nr.128  
Zyra Tel.052223218  
069 4115900 SHEFI

**Zyra e Emergjencave Civile**  
Prefekturni  
Romario Meta  
0688451199

**SKEMA E LAJMËRIMIT PËR RASTE ZJARRESH VITI 2025**

**NJESIA ADMINISTRATIVE NR. 4**

- Njësia Administrative Nr.4
- Skuadrat e fshatrave
- Kryetarët e fshatrave
- Mbrojtja Civile
- Eduart Kaja 0692069153
- Komuniteti

**Administrator i Njësisë  
Administrative Nr. 4**

**Davide Ndoj**  
**0698130666**

**Sektori i Pyjeve**  
Arian Kapidani 068 52 18 400  
Serdi Marksuti 068 32 75 268  
Sektori i Mbrojtjes Civile  
Jetlir Manga 069 36 06 222  
Andri Cerri 068 52 00 696  
Sektori i Bujqësisë  
Ethesva-Velçani 067 74 97 321

**Nënkyryetari**  
Renis Mullaj  
**0675770559**

**Drejtoria**  
Ligjore  
Almeida Rroshi  
**0692022933**

**Prefektura**  
Sekretaria  
**052223559**

**IKMT Artan Greva**  
**0683546626**  
Inspektor i rendit për zonën  
Nr. Tel. 129

**M.Z.SH**  
Rep. Zjarrfikës Tel. 052223333  
dhe Nr.128  
Zyra Tel.0522233218  
**069 4115900 SHEFI**

**Zyra e Emergjencave Civile**  
Prefekturë  
Romario Meta  
**0688451199**

SKEMA E LAJMËRIMIT PËR RASTE ZJARRESH VITI 2025

**NJESIA ADMINISTRATIVE NR.1**

- Njësia Administrative Nr.1
- Skundrat e fshatrave
- Kryetarët e fshatrave
- Mbrotja Civile
- Komuniteti

Administrator i Njësise  
Administrative Nr. 1

Roland Cobanaj  
0698130666

Sektori i Pyjeve  
Arian Kapidani 068 52 18 400  
Serdi Maksuti 068 32 75 268  
Sektori i Mbrotjes Civile  
Jetlir Manga 069 36 06 222  
Andri Cerri 068 52 00 696  
Sektori i Bujqësisë  
Etleva Velçani 067 74 97 321

Drejtoria  
Ligjore  
Almeida Rroshi  
0692022933

Prefektura  
Nën kryetari  
Renis Mullaj  
0675770559

Sekretaria  
052223559

Zyra e Emergjencave Civile  
Prefekturë  
Romario Meta  
0688451199

M.Z.SH  
Rep. Zjarrfikes Tel. 052223333  
dhe Nr.128  
Zyra Tel.052223218  
069 4115900 SHEFI

IKMT Artan Greva  
0683546626  
Inspektor i rendit për zonën  
Nr. Tel. 129